



# Programi i shkencave shoqërore

ALBANSKA

Utbildningsinfo

Skolverket

**Programi i shkencave shoqërore, si përgatitje për shkollën e lartë, të çon deri në një provim me diplomë që mundëson pranimin tënd në shkollën e lartë.**

Programi i shkencave shoqërore të drejtohet ty që ke interesim për zhvillimin dhe funksionimin e njeriut dhe të shoqërisë sot në mënyra të ndryshme. Shkollimi është bazë për studime të mëtejshme në një lëmi të gjerë brenda shkencave shoqërore në shkollën e lartë.

## TRI DREJTIME TË NDRYSHME

### Shkenca e sjelljes

- Ti fiton njohuri për zhvillimin e njeriut, socializimin dhe ndërveprimin. Ti merr më shumë mirëkuptim për veprimet e njerëzve si individë, si anëtarë grupi dhe si qytetarë. Ti studion komunikimet, mësimin dhe mënyrën e udhëheqjes.

### Mediat, informimi dhe komunikimet

- Ti mëson për rolin shoqëror të mediave, teknikat e mediave, gazetarinë, informimin, reklamat dhe format interaktive të komunikimit. Ti studion se si mediat ndikojnë në pikëpamjet dhe botëkuptimin e njerëzve.

### Shkencat shoqërore

- Ti fiton njohuri për strukturat shoqërore dhe kushtet e jetës së njerëzve. Ti zgjeron dhe thellon njohuritë e tua në çështje të ndryshme shoqërore duke interpretuar, sqaruar dhe përdorur metodat e shkencave shoqërore.

## Përmbajtja e arsimit

Ti zhvillon njohuritë e tua për kushtet shoqërore në Suedi dhe në botë. Ti meson për ndërveprimin e individit dhe të shoqërisë dhe si janë ndryshuar kushtet e jetës së njeriut gjatë historisë. Ti studion njeriun si individ, anëtar grupi dhe si qytetar. Ti studion strukturat, veprimtaritë dhe funksionet e shoqërisë. Ti ke mundësi për të reflektuar rreth çështjeve të demokracisë, komunikimit, etikës, gjinisë, ambientit dhe pushtetit nga pikëpamjet ekonomike, sociale dhe politike.

## Programi është i planifikuar në këtë mënyrë

Në programin e shkencave shoqërore lëndët e përbashkëta të gjimnazit janë: gjuha angleze, historia, edukimi fizik dhe shëndetësor, matematika, shkencat natyrore, njohuritë fetare, shkencat shoqërore, gjuha suedeze ose suedishtja si gjuhë e dytë. Në programet me përgatitje për shkollën e lartë ti studion më shumë kurse teorike se sa në programet profesionale.

Lëndët karakteristike të përbashkëta në programet janë: Filozofia, gjuhët moderne dhe psikologjia.

Ti ke mundësi specializimi dhe zgjerimi brenda programit. Kjo quhet studime të thelluara. . Mund të përfshihen p.sh. këto lëndë: Animacioni, artet figurative, biologjia, krijimtaria digjitale, prodhimi i filmit dhe televizionit, filozofia, gjeografia, komunikimi grafik, drejtësia, arti dhe kultura, komunikimi me mediat, gjuhët moderne, pedagogjia, psikologjia, sociologjia dhe teknikat e internetit. Bëj pyetje në shkollë cilat janë lëndët për studime të thelluara që ofrohen.

Ti ke gjithashtu një zgjedhje individuale për të vendosur ç'ka dëshiron ti të studiosh. Bëj pyetje në shkollë cilat janë kurset që ofrohen.

### **Format e punës**

Në program ti zhvillon një qëndrim shkencor dhe kritik, duke mësuar të gjykosh nëse deklaratat janë të bazuara në fakte dhe të dallosh vlerësimet në burime të ndryshme. Ti kërkon, seleksionon dhe përpunon të dhënat me sy kritikë.

Ti zhvillon aftësitë e tua për të bashkëpunuar, për të punuar në mënyrë të pavarur, për të marrë përgjegjësi, për të parë mundësitë, për të marrë iniciativa dhe për të zbatuar idetë në veprime praktike.

### **Punim Gjimnazi**

Në përfundim të Programit të shkencave shoqërore duhet të përpilosh një punim gjimnazi. Ti duhet të parashtrosh një problem, të planifikosh, zbatosh dhe vlerësosh një punë tematike, me pikënisje nga lëmi të rëndësishme njohurie në program.

### **Vini re**

Nëqoftëse ti kërkon një kompetencë të posaçme për një arsimim në shkollën e lartë, është me rëndësi që të planifikohen studimet e tua. Bisedo lirisht me një këshilltar studimi ose profesioni, nëse ti dëshiron të vazhdosh studimet në shkollën e lartë.

Ti ke gjithmonë të drejtë, brenda zgjedhjes individuale, për të zgjedhur edhe një kurs të edukimit fizik dhe shëndetsor si dhe një kurs estetik.